

VENDIM
Nr. 226, datë 23.4.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “A”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a” të listës, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

b) Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen individët e renditur në shkronjën “b”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

c) Nga lista e shkronjës “C”, “Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohet individi i renditur në shkronjën “c”, “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-SË)

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBANËT

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”;

1. QARI; SAIFULLAH; TOKHI.

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

b) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. MALIK; MUHAMED; ISHAQ.

2. JABER; ABDALLAH; JABER; AHMAD AL- JALAHMAH.

c) Lista e individëve të çregjistruar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. YACINE; AHMED; NACER.

Shënim. Gjeneralitet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.